



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 788/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|-----------------|------------|
| Evis Shurdha | Kryetar |
| Spiro Kuro | Zv/Kryetar |
| Leonard Gremshi | Anëtar |
| Hektor Balluku | Anëtar |
| Kleves Janku | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 12.10.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Nika” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-46869-08-05-2016, me objekt: “Rikonstruktion i ambienteve të repartit të reaminacionit”, me fond limit 28.709.513 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.08.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër.

Ankimues:

“Nika” sh.p.k
Bulevardi Skënderbeg, pas Kinema Milenium, Shkodër

Autoriteti kontraktor:

Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.08.2016 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-46869-08-05-2016, me objekt: “*Rikonstruksion i ambienteve të repartit të reaminacionit*”, me fond limit 28.709.513 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.08.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër.

II.2. Në datën 09.09.2016 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar.

Sipas këtij klasifikimi renditja e ofertave pa TVSH, është si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------|----------------------------------|
| 1. “Aurora Konstruksion” sh.p.k | 22.865.399,00 lekë, skualifikuar |
| 2. “Kacdedja” sh.p.k | 24.500.519,00 lekë, skualifikuar |
| 3. “Alb-Konstruksion” sh.p.k | 26.092.544,00 lekë, skualifikuar |
| 4. “Nika” sh.p.k | 26.426.346,00 lekë, skualifikuar |
| 5. “Gjikuria” sh.p.k | 27.372.487,00 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomik “Nika” sh.p.k rezulton i skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

“*Mungese e theksuar dokumentacioni:*

1. *Pika J • Nuk eshte prezantuar deklarata nga ana e ofertuesit sipas tabelës së lartepërmendur.*

Eshte paraqitur nje autorizim i kompanise IMPACT per shoqerine ofertuese NIKA, qe ne rast te fitimit te kesaj gare do ta furnizojë me pajisjet e paraqitura ne tabele me numer rendor 3-6. Por kjo kompani merret me projektim, furnizim, instalim dhe mirembajtje, jo me prodhimin e ketyre pajisjeve. Pikerisht lidhja midis distributorit IMPACT dhe prodhuesit nuk eshte paraqitur ne kete gare.

2. *Kataloget per pajisjet me numer rendor 3,5,6 nuk jane perkthyer dhe markuar ashtu sic eshte kerkuar ne DST .*
3. *Per pajisjen me numer rendor 4 “Central MNZ 8 zona - 33sensore” nuk eshte paraqitur katalog.*
4. *Mungon Libreza e punes per ing.mekanik.*
5. *Ofertuesi ka paraqitur deklarate ku ka deklaruar vetem emrin e drejtuesit teknik Gentiana Mosko, nderkohe qe emrat e stafit teknik qe do te angazhohen ne object nuk jane dhene fare, por eshte shprehur thjesht qe drejtuesi teknik Gentiana Mosko do te asistohet nga inxhinieret e stafit teknik. .”*

II.4. Në datën 13.09.2016 operatori ekonomik “Nika” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij. Në ankesë pretendohet si vijon:

“Në datën 09.09.2016 njoftohemi nëpërmjet mesazhit elektronik në llogarinë tonë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publikme vendimin e KVO-së të Drejtorisë së Spitalit Rajonal Shkodër. Ky vendim bën vlerësimin e procedurës, kuotimin e operatave ekonomike pjesëmarrës dhe na skualifikon ne si operator ekonomik nga procedura e mëtejshme me pretendimin se:

- *Autorizimi i prodhuesit nuk është nga prodhuesi por nga distributori.*
- *Katalogjet nuk janë të përkthyer*
- *Deklarata mbi drejtuesin teknik nuk përfshin të gjithë inxhinierët e kërkuar.*

Vendimi është absolutisht i padrejtë dhe i bazuar në pretendime hipotetike dhe jo në fakte që ekzistojnë. Nga ana jonë janë plotësuar në mënyrë të përpiktë të gjitha dokumentat tekniko-ligjor.

Së pari në lidhje me pretendimin se autorizimi i prodhuesit nuk është i lëshuar nga prodhuesi por nga kompania IMPACT, e cila në bazë të informacioneve të nxjerra nga QKR përse i përket objektit të veprimtarisë së saj nuk rezulton të jetë prodhuese por thjesht shpërndarëse dhe montuese e këtyre pajisjeve. Por rezulton se këto të dhëna janë marrë nga objekti i veprimtarisë në QKR, ku ndër të tjera është specifikuar edhe fakti se kjo kompani është distributor i autorizuar nga prodhuesi për të bërë shitjen, shpërndarjen dhe montimin e këtyre pajisjeve në Shqipëri. Prandaj kjo kompani duke u zotuar se do të furnizojë kompaninë tonë në rast se shpallet fituese në këtë procedurë, do të thotë se ka përmbushur më së miri kriterin e vendosur paraprakisht nga ana juaj.

Së dyti në lidhje me pretendimin se katalogët nuk janë të përkthyer, sqarojmë se ato përmbajnë vetëm foto, logjikisht nuk ka kuptim që të kërkohet përkthimi i fotove.

Së treti në lidhje me pretendimin se nuk janë përcaktuar se drejtues të projektit do të jenë të gjithë inxhinierat, sqarojmë se nga na ajonë është dorëzuar deklarata që përcaktojmë se drejtuese do të jetë Ing. G.M dhe se ajo do të asistohet nga të gjithë inxhinierët e tjerë e

tjerë të shoqërisë. Po ti referohemi licencës së shoqërisë dhe listpagesave tona rezulton se inxhinier të shoqërisë sonë janë të gjithë ato që ju i keni kërkuar në DST.”

II.5. Në datën 19.09.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën.

II.6. Në datën 27.09.2016 ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 06.10.2016 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacioni i autoritetit kontraktor mbi trajtimin e ankesës dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe dokumentave e informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Sipas njoftimit elektronik të datës 09.09.2016 rezulton se ankimesi është skualifikuar për arsye të mëposhtme:

1. *Pika J • Nuk është prezantuar deklarata nga ana e ofertuesit sipas tabelës së lartepërmendur.*

Është paraqitur një autorizim i kompanisë IMPACT për shoqërinë ofertuese NIKA, që në rast të fitimit të kësaj gare do ta furnizoje me pajisjet e paraqitura në tabelë me numer rendor 3-6. Por kjo kompani merret me projektim, furnizim, instalim dhe mirëmbajtje, jo me prodhimin e këtyre pajisjeve. Pikerisht lidhja midis distributorit IMPACT dhe prodhuesit nuk është paraqitur në këtë gare.

2. *Kataloget për pajisjet me numer rendor 3,5,6 nuk janë përthyer dhe markuar ashtu sic është kërkuar në DST .*
3. *Për pajisjen me numer rendor 4 “Central MNZ 8 zona - 33sensore” nuk është paraqitur katalog.*
4. *Mungon Libreza e punës për ing.mekanik.*
5. *Ofertuesi ka paraqitur deklaratë ku ka deklaruar vetëm emrin e drejtuesit teknik Gentiana Mosko, nderkohe që emrat e stafit teknik që do të angazhohen në objekt nuk janë dhënë fare, por është shprehur thjesht që drejtuesi teknik Gentiana Mosko do të asistohet nga inxhinieret e stafit teknik. .”*

III.2. Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Nika” sh.p.k rezulton se janë kundërtuar tre arsye skualifikimi si më poshtë:

Së pari në lidhje me pretendimin se autorizimi i prodhuesit nuk është i lëshuar nga prodhuesi por nga kompania IMPACT, e cila në bazë të informacioneve të nxjerra nga QKR përrsa i përket objektit të veprimtarisë së saj nuk rezulton të jetë prodhuese por thjesht shpërndarëse dhe montuese e këtyre pajisjeve. Por rezulton se këto të dhëna janë marrë nga objekti i veprimtarisë në QKR, ku ndër të tjera është specifikuar edhe fakti se kjo kompani është distributor i autorizuar nga prodhuesi për të bërë shitjen, shpërndarjen dhe montimin e këtyre pajisjeve në Shqipëri. Prandaj kjo kompani duke u zotuar se do të furnizojë kompaninë tonë në rast se shpallet fituese në këtë procedurë, do të thotë se ka përmbushur më së miri kriterin e vendosur paraprakisht nga ana juaj.

Së dyti në lidhje me pretendimin se katalogët nuk janë të përkthyer, sqarojmë se ato përmbajnë vetëm foto, logjikisht nuk ka kuptim që të kërkohet përkthimi i fotove.

Së treti në lidhje me pretendimin se nuk janë përcaktuar se drejtues të projektit do të jenë të gjithë inxhinierat, sqarojmë se nga na ajonë është dorëzuar deklarata që përcaktojmë se drejtuese do të jetë Ing. G.M dhe se ajo do të asistohet nga të gjithë inxhinierët e tjerë e tjerë të shoqërisë. Po ti referohemi licencës së shoqërisë dhe listpagesave tona rezulton se inxhinier të shoqërisë sonë janë të gjithë ato që ju i keni kërkuar në DST.”

III.3. Në ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik rezulton se nuk është dhënë asnjë argument apo kundërshtim lidhur me arsyen e tretë dhe të katërt të skualifikimit sipas njoftimit të datës 09.09.2016 sipas së cilave:

- *Per pajisjen me numer rendor 4 “Central MNZ 8 zona - 33sensore” nuk eshte paraqitur katalog.*
- *Mungon Libreza e punes per ing.mekanik.*

III.4. Duke mbajtur në konsideratë faktin që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i ankesës i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, dy prej arsyeve të skualifikimit nuk janë ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në Komisionin e Prokurimit Publik.

III.5. Në nenin 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 , 5, 6 dhe 7 parashikohet se:

“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji” (pika 2).

“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës (pika 5).”

“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në

Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor” (pika 6).

“Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme” (pika 7).

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Nika” sh.p.k, nuk janë ndjekur shkallët e ankimimit lidhur me arsyet e skualifikimit : “Per pajisjen me numer rendor 4 “Central MNZ 8 zona - 33sensore” nuk eshte paraqitur katalog” dhe “Mungon Libreza e punes per ing.mekanik”.

Në këto kushte, duke qënë se aktualisht kanë përfunduar afatet e ankimimit në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, rrjedhimisht arsyet e skualifikimit të cilat nuk janë ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në KPP, nuk mund të merren në shqyrtim nga ky komision e për rrjedhim ai rezulton të ngelet i skualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Edhe në hipotezën se pretendimet e tjera të paraqitura pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP do të qëndronin, operatori ekonomik ankimues nuk do të ndryshonte gjendjen e tij faktike e juridike, por do të mbetej sërish i skualifikuar nga procedura në fjalë, për shkaqet e skualifikimit të bëra më dije në datën 09.09.2016, të cilat nuk janë ankimuar pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP, në respekt të shkallëve të ankimimit.

Përsa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik “Nika” sh.p.k, përsa i përket skualifikimit të tij, nuk do të merret në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Nika” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-46869-08-05-2016, me objekt: “Rikonstruksion i ambienteve të repartit të reaminacionit”, me fond limit 28.709.513 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.08.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 2054 Protokolli;

Datë 27.09.2016

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha

